



**BANKA E
SHQIPËRISË**

Njoftim për Shtyp

Zyra e Shtypit
25 shtator 2006

**Mbi veprimtarinë e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë
zotit Ardian Fullani gjatë zhvillimit të mbledhjeve vjetore të Bankës Botërore
dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar**

Nga data 17 deri më datën 20 shtator 2006, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani dhe njëkohësisht Guvernatori i Shqipërisë pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar, në krye të një delegacioni të Bankës së Shqipërisë, mori pjesë në mbledhjet vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Grupit të Bankës Botërore, që zhvilloi punimet në Singapor.

Gjatë qëndrimit të tij në Singapor, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë zhvilloi takime të shumta me përfaqësues të lartë të FMN-së, BB-së dhe të bankave qendrore, anëtare të FMN-së. Në takimet e zhvilluara me përfaqësues të FMN-së dhe të BB-së, pala shqiptare u përfaqësua nga Ministri i Financave, zoti Ridvan Bode dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zoti Ardian Fullani.

Mbledhja e sivjetshme pati si argumentin e saj bazë reformimin e institucionit kryesor të Bretton Woods-it, Fondit Monetar Ndërkombëtar. Realitetet e reja ndërkombëtare kishin imponuar prej kohësh nevojën për një përfaqësim më dinjitoz të ekonomive në zhvillim në vendimmarrjen e këtij institucioni. Votimi i bërë në fillim të punimeve shënoi hapin e parë të reformave, duke i caktuar një kuotë anëtarësimi¹ më të madhe Kinës, Koresë së Jugut, Meksikës dhe Turqisë. Ky vendim ka krijuar premisat për reformimin më të thellë të institucionit në historinë e tij 60-vjeçare.

¹ Kuota përcakton të drejtën e vendit për të votuar në FMN dhe për rrjedhim, dhe shkallën e influencës në vendimmarrje.

i. Takimet me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Në kuadër të takimeve me përfaqësues të lartë të FMN-së, u zhvilluan bisedime me:

z. Michael Deppler Drejtor i Evropës në FMN, z. Arrigo Sadun, Drejtor Ekzekutiv për Shqipërinë në FMN, z. Charles Enoch, Zëvendësdrejtor në Departamentin e Tregjeve Monetare dhe të Kapitaleve, z. Alfredo M. Leone, Zëvendësdrejtor në Departamentin e Statistikës.

Në të gjitha takimet, nga të dyja palët u vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet FMN-së dhe autoriteteve të Shqipërisë. Prej të gjithë përfaqësuesve të lartë të FMN-së u pranua se Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në fushat respektive, dhe se parashikimet për të ardhmen e afërt dhe atë të largët mbeten optimiste.

Vëmendje e veçantë iu kushtua zhvillimeve më të fundit makroekonomike problemeve dhe çështjeve të ndryshme, që lidhen me politikën fiskale, politikën monetare, stabilitetin monetar dhe atë financiar në përgjithësi. Gjatë këtyre takimeve, Guvernatori Fullani i siguroi përfaqësuesit e FMN-së se: “Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të jetë e kujdesshme në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik nëpërmjet kontrollit të presioneve inflacioniste, të monitorimit e mbikëqyrjes me efektivitet dhe vigjilencë të ritmeve të rritjes dhe performancës së portofolit të kredisë”.

Guvernatori Fullani u kërkoi përfaqësuesve të FMN-së që të vazhdojnë të ndihmojnë Bankën e Shqipërisë me asistencë teknike në fushat e zbatimit të politikës monetare, të mbikëqyrjes, të kontrollit të brendshëm, të administrimit të borxhit publik si dhe në ngritjen e zyrës së regjistrimit të kredive.

Nga përfaqësuesit e lartë të FMN-së u shpreh mirëkuptimi për të vazhduar projektet e ndihmës teknike për Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave, me qëllim përshejtimin e reformave strukturore, zhvillimin e tregut financiar, përmirësimin e administrimit të borxhit të brendshëm etj...

Në takimin me departamentin e statistikës, u ra dakord që të vazhdojë edhe më tej bashkëpunimi teknik për çështje që lidhen me bilancin e pagesave, treguesit e ekonomisë reale, çështjet statistikore që lidhen me inflacionin e shënjestruar etj.. Gjithashtu, u ra dakord që të vazhdojë dhënia e asistencës teknike për stafin e BSH-së, të MF-së dhe të INSTAT-it, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të statistikave shqiptare. Në këtë takim ishte e pranishme edhe Drejtoresha e INSTAT-it, Znj. Gerta Picari.

ii. Takimet me Bankën Botërore.

Në kuadër të takimeve me përfaqësues të lartë të BB-së, u zhvilluan diskutime intensive me: z. Shigeo Katsu, Zëvendëspresident i Bankës Botërore për Rajonin e ECA, z. Biaggio Bossone, Drejtor Ekzekutiv për Shqipërinë në BB etj..

Në këto takime të përbashkëta të Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave u vlerësuan marrdhëniet e mira të bashkëpunimit midis dy institucioneve dhe intesifikimi i këtyre marrdhënieve.

Nga ana e tij, z. Ardian Fullani i njohu përfaqësuesit e lartë të Bankës Botërore me zhvillimet makroekonomike në Shqipëri, masat e ndërmarra për të ruajtur këtë stabilitet nga presionet inflacioniste që janë prezente në tregun shqiptar, si dhe synimet e Bankës së Shqipërisë për të konsoliduar arritjet e deritanishme, veçanërisht mbajtjen nën kontroll të inflacionit brenda intervalit të synuar 2 – 4 për qind.